

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Malli / *esh-Sheuk* / الشَّوْقُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"مَنْ كَانَ يَرْجُو لِقَاءَ اللَّهِ فَإِنَّ أَجَلَ اللَّهِ لَآتٍ."

"Kushdo që shpreson takimin me Allahun – vërtet afati i caktuar nga Allahu do të përfundojë." (el-Ankebut, 5)

Malli është fryma e vrullshme¹ e zemrës ndaj dikujt që mungon. Në komunitetin e ndjekësve të shtegut të pastrimit shpirtëror, mangësia në mall konsiderohet të jetë një dëm i pamasë, meqë malli ndihet për dikë që mungon; ndërsa shtegu i këtij komuniteti bazohet në të parët (Atë). Për këtë mangësi Kurani nuk përmend mallin (*esh-Sheuk*)². Kjo ka tri nivele:

Malli i robit për xhenet, që bën që:

- I frikësuar të gjejë siguri
- I mërzituri të gjejë gëzim
- Dhe ai i cili shpreson të arrijë qëllimin e tij.

¹ Mund të përdoren edhe fjalët vijuese: shpërthim, rrjedhë, trazim shpirtëror.

² Shejhu (el-Harawi) bën dallim mes *esh-sheuk* (mallit) dhe *er-rexhaa* (shpresës). Për këtë arsye, ai thotë se Kurani nuk përmend *esh-sheuk*, ndonëse e fillon këtë stacion (shkallë) duke cituar një ajet rreth *er-rexhaa* (shpresës). Suneti përmend *esh-sheuk*. I Dërguari i Allahut ﷺ luste Allahun duke thënë:

"... وَأَسْأَلُكَ لُدَّةَ النَّظَرِ إِلَى وَجْهِكَ وَالشَّوْقَ إِلَى لِقَائِكَ فِي غَيْرِ ضَرَاءٍ مُضِرَّةٍ وَلَا فِتْنَةٍ مُضِلَّةٍ..."

"... Kërkoj kënaqësinë (lezetin) e shikimit në Fytyrën Tënde dhe mallin për takimin me Ty pa ndonjë fatkeqësi që dëmton ose ndonjë sprovë që devijon ..." (en-Nesa'i)

Megjithatë, ka një dallim mes shikimit në Zotin në këtë botë dhe në botën tjetër.

Malli për Allahun, që mbillet nga dashuria e rritur në brigjet e begative, që e bën zemrën të kapet për cilësitë e Tij të shenjta, të ketë mall për bujarinë e Tij, për shfaqjen e begative të Tij dhe për kurorat e hirit të Tij. Ky është një mall që:

- Lehtësohet nga begatitë³
- Përzihet me gëzime⁴
- Dhe zbutet nga durimi⁵

Niveli i tretë është një zjarr që ndizet nga dëlirësia e dashurisë. Ky mall:

- Prish jetesën⁶
- Heq ngushëllimet
- Dhe nuk e qetëson asgjë tjetër përveç takimit⁷.

³ Begatitë e Allahut bëhen si pagesat që jepen para se të kryhet puna, çka bën që të zbutet vrulli i mallit.

⁴ Përzierja me gëzimet e begative të Allahut, ndonëse e lejueshme, të shpërqendron nga malli dhe mund të ta heqë vëmendjen, kështu që duhet të qëndrosh syçelë.

⁵ Personi ende mund ta kontrollojë këtë mall me durim.

⁶ Në një rast, Sufjan eth-Theuri tha se mirëpret vdekjen nga frika e sprovës, ndërsa Jusuf ibn Asbaat tha se parapëlqen të jetojë me arsytimin se ndoshta udhëzohet për pendim të sigurtë. Wuhejb ibn el-Ward tha: “Çfarëdo që është e pëlqyeshme për Allahun, është e pëlqyeshme edhe për mua.” Nëse Ai zgjedh për ne që të jetojmë më gjatë, ne duhet të shfrytëzojmë këtë rast si më së miri për të mbjellë farat e mirësisë që do t’i korrim në ahiret; nëse Ai zgjedh që ne të largohemi më herët, atëherë duhet të jemi të gatshëm dhe pranues.

⁷ Takimi me të Dashurin (i lartësuar qoftë!).